

## NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR

### SPECIALIST-ARKIVIST

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë specialist-arkivist.

**Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.**

I. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

I.1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të plotësojë të gjitha kushtet e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas nenit 21 e 22, të ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar;
- b) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- c) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- d) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

I.2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta.

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master" (të paktën profesional) në Shkenca Juridike/ Ekonomike/ Sociale/ Histori/ Gjuhë-Letërsi, ku edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë

Diplomat e marra jashtë vendit, duhet të jenë të njohura nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

b. Të ketë njohuri në një nga gjuhët e BE-së (preferohet anglisht);

**Kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 20, 21 dhe 22 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II të Vendimit, të Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”,**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë

f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

1.1 Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, si vijon:

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master" (të paktën profesional) në Shkenca Juridike/ Ekonomike/ Sociale/ Histori/ Gjuhë-Letërsi, ku edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë

Diplomat e marra jashtë vendit, duhet të jenë të njohura nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi

b. Të ketë njohuri në një nga gjuhët e BE-së (preferohet anglisht);

**Kritere të preferuara, por jo të nevojshme:**

a) Njohja e proceseve të përpunimit e ruajtjes së fondeve arkivore.

b) Njohja e sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.

**Pergjegjesite kryesore:**

a) Punonjësi pranon, ruan e përpunon aktet proçeduriale e administrative, në përputhje me proçedurat e përshkruara në ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

**Funksionet kryesore:**

a) Merr në dorëzim fashikuj, akte e dokumentacion për arkivim.

b) Përpunon materialet arkivore, duke inventarizuar sipas proçedurave standart të gjitha këto akte, si në formë elektronike, ashtu edhe manuale.

c) Kujdeset për mirëmbajtjen e indekseve dhe regjistrave të arkivës.

d) Përgatit mbi kërkesën e të interesuarve, aktet të cilat do të vendosen këtyre personave në dispozicion pas kontaktimit me Drejtuesin e Prokurorisë dhe prokurorin për mardhëniet me publikun.

ç) Është pjesë e Komisionit të Ekspertizës për përpunimin e materialeve arkivore.

e) Merr pjesë në trajnimet ku trajtohen çështje që lidhen me arkivat.

dh) Bashkërendon me Arkivin Shetëror të Sistemit të Drejtësisë për problematika të vërejtura në veprimtarinë e përditshme.

**Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, deri në datën e përcaktuar, këto dokumenta:**

a) Kërkesë për punësim,

b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.

- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë, dhe master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht .
- g) Fotokopje te librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim vendbanimi.
- i) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, 02.04.2025 për lëvizjet paralele dhe 09.04.2025 për procedurën e pranimin në shërbimin civil

Per çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin telefon +35542282068, ose vizitoni faqen e internetit [Eni.Begaj@pp.gov.al](mailto:Eni.Begaj@pp.gov.al)